

**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT**

**PROGRAMI I LËNDËS SË FILOZOFISË**

**PËR KLASËN E 11<sup>të</sup>**

**TIRANË, TETOR 2016**

## 1. HYRJJE

Studimi i filozofisë i shërben zhvillimit të aftësive intelektuale, të rëndësishme për jetën në tërësi, përtej njohurive dhe aftësive që kërkohen në profesione ose në fusha të veçantë të veprimtarisë njerëzore. Ai zhvillon aftësitë analitike kritike dhe interpretuese që zbatohen dhe janë të domosdoshme në çdo fushë lëndore dhe kontekst jetësor. Ai zhvillon aftësinë dhe prirjen për refleksion dhe vetëshprehje, për të shkëmbyer idetë dhe për të debatuar rreth tyre, për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Studimi i filozofisë ndihmon në përgatitjen e qytetarëve për detyrat që ata kanë ndaj bashkësisë ku jetojnë dhe i pajis ata me përgjegjshmërinë dhe aftësitë e duhura intelektuale për të marrë pjesë në çështjet aktuale të politikës dhe të bashkësisë .

Në këtë mënyrë studimi i filozofisë krijon mundësitë për rritjen e pushtetit intelektual dhe për të përballuar ndryshimet e shpejta e të vazhdueshme që karakterizojnë sot veprimin dhe mendimin njerëzor.

## 2. SYNIMET E LËNDËS

Programi i lëndës së filozofisë synon të pajisë nxënësit me:

- aftësinë për të zgjidhur probleme, mbi bazën e analizës së koncepteve, të përcaktimeve, të argumenteve e të sintezës së larmisë së këndvështrimeve në një të tërë të vetme;
- aftësinë për të organizuar idetë dhe çështjet e ndryshme, për të dalluar dhe për të përzgjedhur atë që është thelbësore në sasinë e shumtë të informacionit me të cilin ndeshemi;
- aftësinë për të komunikuar idetë, duke ofruar mjetet kryesore të vetëshprehjes, si aftësinë për të paraqitur ide duke përdorur argumente të strukturuar mirë dhe sistematikë;
- aftësinë për të shprehur e mbrojtur një qëndrim të caktuar me argumente;
- aftësinë për të ndërtuar e për të mbrojtur një pikëpamje, për të vlerësuar e për të mbajtur parasysh argumentet dhe pikëpamjet e ndryshme dhe të kundërta, aftësinë për të përzgjedhur dhe për të justifikuar zgjedhjen e një alternative;
- aftësinë për të formuluar hipoteza, për të bërë hulumtime, për të parashtruar probleme në mënyrë që të mundësohet zgjidhja e tyre;
- aftësinë e kërkimit, të kuptimit dhe të përballimit të të gjitha problemeve të rëndësishme të jetës;
- aftësinë për të kuptuar lidhjen e filozofisë me dijet dhe aktivitetet e tjera njerëzore, duke përdorur metodologjinë e përshtatshme për trajtimin e çështjeve filozofike, në situata të ndryshme;
- aftësinë e pjesëmarrjes qytetare për të zgjidhur në praktikë probleme të ndryshme jetësore filozofike;
- aftësinë për të zgjedhur një qëndrim të caktuar filozofik e moral në funksion të angazhimit të tij në jetën shoqërore.

# 1. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

## Në fushën e njohurive

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të përshkruajë zhvillimin evoluimin e mendimit filozofik, sipas periudhave historike.
  - të dallojë periudhat kryesore të zhvillimit të mendimit filozofik;
  - të përshkruajë karakteristikat kryesore të periudhës që lidhen me zhvillimin e filozofisë.
- të përshkruajë historinë e mendimit filozofik përmes përfaqësuesve të saj;
- të dallojë e të argumentojë lidhjen e disa prej koncepteve dhe problemeve kryesore të filozofisë me periudhat kryesore të mendimit filozofik në shekuj etj.;
- të dallojë pikëpamjet e kundërta ose të ndryshme në historinë e mendimit filozofik dhe të përshkruajë dallimet dhe pikat e përbashkëta.

## Historicizmi dhe lidhja e kushtëzimi reciprok

Nxënësi duhet të vlerësojë rrymat, mendimin dhe pikëpamjet filozofike, historike etj., në kohë dhe në hapësirë. Për këtë ai duhet të jetë në gjendje:

- të dallojë tiparet thelbësore të periudhës historike të cilës i përket një pikëpamje ose qëndrim filozofik;
- të shpjegojë lidhjen e një rryme, të një pikëpamjeje ose të një qëndrimi filozofik me faktorë historikë (ekonomikë, shoqërorë, politikë, kulturorë, fetarë etj.);
- të analizojë e të vlerësojë kufizimet ose vlerat e filozofëve, të mendimtarëve, të historianëve etj; në kohë dhe në hapësirë;
- të tregojë dhe të argumentojë rolin e filozofisë në përparimin e fushave ose aspekteve të ndryshme të jetës shoqërore e shkencore;
- të dallojë e të përshkruajë mendimin filozofik në Shqipëri në periudha të ndryshme historike;<sup>1</sup>
- të dallojë e të përshkruajë ndikimin e mendimit të përparuar botëror në mendimin filozofik në Shqipëri në periudha të ndryshme historike.

## Ndryshimi dhe vazhdimësia

Nxënësi duhet:

- të kuptojë procesin e ndryshimit dhe të vazhdimësisë së mendimit filozofik dhe të shpjegojë arsyen e ndryshimit dhe vazhdimësisë;
- të dallojë ndryshimet dhe vazhdimësinë historike dhe të tregojë si këto kanë ndikuar në zhvillimin ose ndryshimin e pikëpamjeve filozofike;
- të dallojë tiparet kryesore të shoqërisë së sotme dhe të argumentojë vazhdimësinë e mendimit filozofik.

## Krijimi i mendimi të pavarur

---

<sup>1</sup> Shih rubrikën “Përpunim i njohurive”, si mundësi për realizimin e objektivave që lidhen me mendimin filozofik shqiptar.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të krijojë dhe të respektojë mendimin e tij të pavarur. Për këtë, nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të dallojë ndryshimet që ekzistojnë në mendimin filozofik;
- të shpjegojë pse njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme;
- të dallojë lidhjen e pikëpamjeve të ndryshme me interesa të ndryshme ekonomike, politike, fetare etj;
- të formulojë pikëpamjen e tij dhe të argumentojë pse të tjerët duhet të pranojnë mendimin e tij filozofik.

### **Respektimi i diversitetit**

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të dallojë vlerat pozitive edhe në rrymat filozofike, mendimet e pikëpamjet me të cilat nuk është dakord;
- të argumentojë që çdo mendim, pra edhe mendimi i tij është i kufizuar nga koha dhe vendi, nga interesat, arsimimi, përkatësia ekonomike, shoqërore etj.;
- të tregojë pse të tjerët duhet të pranojnë mendimin e tij filozofik, për të kuptuar pse ai duhet të pranojë pikëpamjet e të tjerëve;
- të pranojë mendimin e tij dhe të tjetrit si mendime plotësuese në tablonë e përgjithshme të mendimit njerëzor të epokës.

Duke u nisur nga synimet e objektivat e lëndës dhe nga problematika filozofike dhe evolucionit filozofik i mendimit, nga tradita e mësimdhënies së lëndës së filozofisë në shkollën tonë dhe nga nevojat e nxënësit shqiptar në kuadrin e formimit të tij tërësor me aftësitë e të menduarit kritik e krijues, lënda e filozofisë në gjimnaz të zhvillohet si **një histori e filozofisë**. Ky trajtim i filozofisë nën formën e një tërësie sistematike:

1. **Së pari**, do t'u jepte përgjigje çështjeve që kanë të bëjnë me origjinat në kohë dhe kufijtë në hapësirë të filozofisë.
2. **Së dyti**, do të jepte mundësi të kuptohej lidhja e filozofisë me dijet dhe aktivitetet e tjera njerëzore të zhvilluara në kohë dhe në hapësirë.
3. **Së treti**, do t'i jepte mundësi nxënësit të njihej me progresin e mendimit filozofik, në kuadrin e bashkëpunimit dhe të ndërvarësisë së tij me faktorët e ekonomikë, shoqërorë, politikë e shkencorë të epokave kryesore historike.

Në këndvështrimin historik mund të përmbliidhen edhe problemet kryesore, me të cilat është hasur mendimi filozofik dhe zgjidhjet që filozofia dhe ky mendim ka ofruar në këtë drejtim. Në këtë kuptim e tërë historia e filozofisë shihet dhe vlerësohet në kuadrin e evolucionit dhe të progresit të mendimit njerëzor e filozofik dhe të shoqërisë njerëzore.

Gjithashtu, duke u nisur nga problematika aktualisht më e diskutueshme dhe e lidhur me shqetësimet e kohës, autorët e zgjedhur si përfaqësues kuptimplotë të kohës dhe të periudhave historike e të mendimit filozofik, duhet të shihen nën një skemë, pak a shumë unike, e cila të përfshijë jo vetëm risitë filozofike të çdo autori në kuadrin e historisë së filozofisë, por edhe problemet konkrete si ato të kuptimit të njeriut, të marrëdhënieve të njeriut me natyrën dhe njeri-tjetrit, problemet e drejtësisë, filozofisë politike, të lirisë dhe të ndonjë problemi të rëndësishëm social të epokës përkatëse.

Për rrjedhojë, trajtimi historik:

- do të aftësojë nxënësin të kuptojë dhe të vlerësojë procesin e zhvillimit të mendimit filozofik dhe të çdo mendimi në kohë dhe në hapësirë, pra në kuadrin e një konteksti të caktuar historik e kulturor;
- do të aftësojë nxënësin të vlerësojë kontributet e mendimit njerëzor ose të individëve të ndryshëm në kuadrin e kohës në të cilën kanë jetuar e vepruar;
- do të aftësojë nxënësin të analizojë dhe të vlerësojë mendimin e sotëm filozofik dhe çdo mendim tjetër në kuadrin e bashkëveprimit dhe të ndërvarësisë me faktorët e shumtë që veprojnë në kohën e sotme;
- do të aftësojë nxënësin të krijojë ose të përzgjedhë mendimin ose qëndrimin e tij filozofik për problemet dhe zgjidhjet e kohës etj.

Në këtë këndvështrim programi i filozofisë së klasës 11<sup>te</sup> të gjimnazit sugjeron periudhat, autorët dhe problemet (ose konceptet) e mëposhtme.

**Të gjithë objektivat e përgjithshëm të lëndës, duhet të mbahen parasysh për çdo linjë, pra për çdo periudhë, autor dhe problem filozofik që përbën përmbajtjen e sugjeruar të linjës.**

Linjat	Përmbajtja e linjës (autorë, koncepte, probleme)
<b>Linja I. Periudha helenike</b>  <b>9 orë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hyrje e shkurtër në të cilën të përshkruhen rrethanat historiko-shoqërore të lindjes së filozofisë së kësaj periudhe dhe veçorive më të përgjithshme të kohës, veçanërisht lidhjen e mitit me arsyen dhe ndikimin që ato kanë pasur në mendimin dhe praktikën e kohës.</li> <li>▪ <b>Filozofia parasokratike.</b></li> <li>▪ <b>Sofistët dhe Sokrati.</b></li> <li>▪ <b>Platoni;</b> dialektika platonike, reminishenca dhe miti, filozofia dhe politika, drejtësia.</li> <li>▪ <b>Aristoteli;</b> logjika, metafizika, morali, politika.</li> </ul>
<b>Linja II. Periudha romake</b>  <b>5 orë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të periudhës, që përcaktuan daljen e drejtimeve të mëposhtme filozofike:</li> <li>▪ <b>Stoicizmi:</b> logjika, fizika, morali</li> <li>▪ <b>Epikurianizmi:</b> logjika, fizika, morali.</li> <li>▪ <b>Skepticizmi</b></li> </ul>
<b>Linja III. Drejtimet filozofike në shekujt e parë të erës sonë</b>  <b>5 orë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të epokës perandorake.</li> <li>▪ <b>Seneka;</b> stoicizmi i epokës perandorake dhe morali.</li> <li>▪ <b>Mark Aureli;</b> morali dhe mësimi i filozofisë.</li> <li>▪ <b>Neoplatonizmi</b> (Plotini).</li> </ul>
<b>Linja IV. Mesjeta dhe Rilindja</b>  <b>10 orë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të epokës, e veçanërisht i atyre që trajtojnë marrëdhëniet e arsyes dhe të besimit, që përcaktuan këtë tip të mendimit filozofik në këtë periudhë.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Arsyeya dhe besimi</li> <li>▪ <b>Shën Agustini</b>; teologjia dhe arsyeya, morali, qyteti i Zotit dhe qyteti tokësor.</li> <li>▪ <b>Thoma Akuinas</b>; arsyeya dhe besimi, teoria e njohjes, provat e ekzistencës së Zotit, përshtatja e Aristotelit në funksion të teologjisë së krishterë</li> <li>▪ <b>Avicena</b>; teologjia myslimane, ndikimi i Aristotelit dhe neoplatonizmit, morali, teoria e njohjes.</li> <li>▪ <b>Averroes</b>; komentimi i Aristotelit, teoria e intelektit.</li> <li>▪ Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të epokës së Rilindjes.</li> <li>▪ <b>Montenji</b>; pirroizmi i tij, morali dhe politika.</li> <li>▪ <b>Kampanella</b>, utopia</li> </ul>
<p><b>Linja V. Shekulli XVII</b></p> <p><b>9 orë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme historiko – shoqërore që përcaktuan daljen e racionalizmit dhe të empirizmit dhe ndikimi i tyre në problematikën filozofike dhe në mendimin e kohës.</li> <li>▪ <b>Frensis Bekon</b>; kuptimi dhe shkencat eksperimentale, Organoni i Ri.</li> <li>▪ <b>Dekarti</b> dhe racionalizmi; metoda, trupi dhe shpirti.</li> <li>▪ <b>Spinoza</b>; reforma e mendimit, natyra njerëzore, liria dhe domosdoshmëria.</li> <li>▪ <b>Hobsi</b>; gjendja nyrrore dhe kontrata shoqërore.</li> <li>▪ <b>Xhon Loku</b>; teoria e njohjes, politika, idetë.</li> </ul>
<p><b>Linja VI. Shekulli XVIII</b></p> <p><b>9 orë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme historiko – shoqërore të shekullit që përcaktoi problemet e mëdha filozofike të kohës. Filozofia e shekullit XVIII si pararendëse e lëvizjeve të mëdha në Evropë drejt një shoqërie më të mirë dhe më të lirë.</li> <li>▪ <b>Monteskjë</b>; natyra e ligjeve, ndarja e pushteteve, determinizmi gjeografik.</li> <li>▪ <b>David Hjum</b> ; teoria e njohjes, kritika e fesë, morali dhe politika</li> <li>▪ <b>Enciklopedistet dhe Volteri</b>; teoria e natyrës, njeriu dhe historia, toleranca.</li> <li>▪ <b>Rusoi</b>; kontrata, liria, natyra njerëzore.</li> <li>▪ <b>Kanti</b> dhe filozofia e tij kritike; arsyeya teorike dhe praktike, aftësia e gjykimit.</li> </ul>
<p><b>Linja VII. Shekulli XIX dhe XX.</b></p> <p><b>21 orë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme historike që përcaktuan sistemet e mëdha filozofike. Kritika e tyre. Pikënisjet për drejtimit bashkëkohore të filozofisë.</li> <li>▪ <b>Utilitarizmi</b> anglez: (Bentam), morali e drejta.</li> <li>▪ <b>Xhon Stjuart Mill</b>; morali dhe e drejta</li> <li>▪ <b>Hegeli</b>; dialektika, e drejta, historia.</li> <li>▪ <b>Marks</b>; materializmi, historia, politika, ateizmi.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>Fridrih Niçe</b>; kritika e vlerave, mbinjeriu, ateizmi.</li> <li>▪ <b>Kirkegardi</b>; individi, ekzistenca.</li> <li>▪ Disa drejtime dhe probleme të filozofisë bashkëkohore</li> <li>▪ <b>Henri Bergson</b>: Njohja, Problemi i kujtesës, njeriu natyra dhe funksioni i inteligjencës në raport me jetën.</li> <li>▪ <b>Haideger</b>; njeriu, ontologjia, ankthi.</li> <li>▪ <b>Sartri</b>; ekzistenca, liria, hici</li> <li>▪ <b>Xhon Djuj</b>; etika, edukimi, shoqëria.</li> <li>▪ <b>Vitgenshtain</b> dhe filozofia e gjuhës; qëllimi i filozofisë, struktura logjike e gjuhës dhe bota.</li> <li>▪ <b>Psikanaliza dhe filozofia</b> (Frjod, From)</li> <li>▪ <b>Hermeneutika, Strukturalizmi dhe Poststrukturalizmi</b> (postmodernizmi)</li> </ul>
--	--

### 3. KËRKESAT E LËNDËS SË FILOZOFISË NDAJ LËNDËVE TË TJERA

<b>Filozofia</b>	<b>Letërsia</b>
	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë lidhjen e veprimtarisë artistike me jetën ekonomike, shoqërore, kulturore etj. në etapa të ndryshme të zhvillimit shoqëror;</li> <li>▪ të interpretojë karakteristikat e veprave letrare në periudha të ndryshme kohore dhe kontekste të ndryshme kulturore;</li> <li>▪ të përshkruajë lidhjen ndërmjet iluminizmit shqiptar me letërsinë iluministe evropiane;</li> <li>▪ të përshkruajë veprimtarinë e shkrimtarëve të mëdhenj, nëpërmjet veprave dhe jetëshkrimeve, një pjesë e mirë e të cilëve janë edhe filozofë;</li> <li>▪ të mbajë qëndrime të drejta kritike dhe krijuese në fushën e letërsisë.</li> </ul>
<b>Filozofia</b>	<b>Historia</b>
	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë tiparet kryesore të zhvillimit historik, duke i lidhur ngjarjet historike, idetë etj. me kushtet dhe rrethanat ekonomiko-shoqërore në të cilat kanë ndodhur;</li> <li>▪ të përshkruajë kontributin e personaliteteve të shquara në histori në raport me mundësitë e kohës.</li> </ul>
<b>Filozofia</b>	<b>Sociologjia</b>
	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë lidhjen ndërmjet pikëpamjeve morale, fetare etj. me realitetin shoqëror;</li> <li>▪ të analizojë rolin që e faktorëve të tillë si familja, shkolla, shteti, kultura, komuniteti në krijimin e koncepteve të individit dhe shoqërisë;</li> <li>▪ të shpjegojë rolin e kulturës dhe të traditës kulturore në formësimin dhe progresin e njeriut;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të analizojë krijimin e ndërgjegjes shoqërore në bashkëveprimin me kushtet shoqërore.</li> </ul>
<b>Filozofia</b>	<b>Psikologjia</b>
	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë botën dhe zhvillimin intelektual të njeriut, aftësitë për të kultivuar mendimin kritik dhe krijues;</li> <li>▪ të përshkruajë karakteristikat zhvillimit shpirtëror, ndjesitë, gjendjet emocionale, kultivimin e tyre në lidhje me jetën shoqërore.</li> </ul>
<b>Filozofia</b>	<b>Gjuha e huaj</b>
Në përfundim të trajtimit të lëndës së gjuhës së huaj, p.sh. Gjuhës angleze, italiane etj.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të dallojë dhe të shpjegojë prejardhjen e termave që janë koncepte filozofike:             <ul style="list-style-type: none"> <li>○ “a priori”, “a posteriori”, determinist, empiricism, rationalism, truth, pragmatist, skepticism, theological, utilitarianism etj. Or,</li> <li>○ pragmatismo, empirismo, scetticismo etj.</li> </ul> </li> </ul>

Në mënyrë të ndërsjellë, njohuritë që merren në lëndën e filozofisë, kuptimi dhe interpretimi i koncepteve dhe i rrymave filozofike e ndihmon nxënësin për të konsoliduar njohuritë në lëndë të tjera, sikurse janë ato që merr në letërsinë e traditës dhe të sotme, duke pasqyruar edhe evoluimin e tyre.

#### 4. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program zbatohet për 72 orë. Programi është një dokument zyrtar. Ai është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e filozofisë. Dokument tjetër i rëndësishëm është korniza kurrikulare e gjimnazit. Hartimi i programit është mbështetur te korniza kurrikulare.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- synimeve të linjave ndër-kurrikulare,
- vlerësimit të nxënësit me notë,
- parimeve të mësimdhënies..

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, racore, fetare etj.

#### Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që t’i realizojnë ato. Realizimi i objektivave brenda linjave dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. Ato duhen përcaktuar sipas nivelit të nxënësve. Për shembull, nëse programi i lëndës së filozofisë kërkon që nxënësi të jetë i aftë: “Të dallojë e të përshkruajë ndikimin e mendimit të përparuar botëror në mendimin filozofik në Shqipëri në periudha të ndryshme historike”, kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u



jepet mundësia të realizojnë këtë objektiv. Për realizimin e këtij objektivi nxënësit duhet t'i jepet detyra, koha, informacioni i vlefshëm dhe mundësi të tjera që të mbledhë fakte për çështjen në fjalë dhe të bëjë interpretimin e tyre. Nëse zbatuesi i programit (mësuesi, autori i tekstit) nuk e mundëson këtë, kjo do të thotë se ai/ajo nuk e ka zbatuar programin lëndor lidhur me këtë objektiv.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi duhet të ketë të qartë nivelet e arritjes së një objektivi nga nxënësi si më poshtë:

- Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët).
- Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar).
- Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë).

Për shembull, programi kërkon që nxënësi të jetë i aftë:

- Të dallojë pikëpamjet e kundërta ose të ndryshme në historinë e mendimit filozofik dhe të përshkruajë dallimet dhe pikat e përbashkëta.

Ky objektiv mund të arrihet në disa nivele:

- I. Nxënësi dallon kundërshtitë në pikëpamje.
- II. Nxënësi shpjegon lidhjen ndërmjet një pikëpamjeje me pasojat që ka zbatimi i saj në praktikë.
- III. Nxënësi krijon dhe mbron qëndrimin e tij për çështjen në diskutim, të mbështetur me argumente që mbajnë parasysh edhe argumentet e të tjerëve, të ndryshme nga të vetat.

Së pari, mësuesi duhet t'i krijojë çdo nxënësi mundësinë të shprehë arritjet e veta në të gjitha nivelet. Kjo do të thotë se mësuesi nuk duhet të paragjykojë si përfundimtare aftësitë e një nxënësi që arrin nivelin e parë, por t'i japë atij, me anë të pyetjeve të tjera, mundësinë të shprehet edhe në nivelet e tjera.

Së dyti, mësuesi duhet të vlerësojë nxënësin për nivelin e shprehur të arritjeve, pasi t'i ketë dhënë atij të gjitha mundësitë të shprehë aftësitë e veta.

## **Orët mësimore**

Programi i filozofisë për klasën e 12 të gjimnazit është strukturuar në bazë të parimit kronologjik-tematik, për këtë arsye linjat e programit duhet të zbatohen në vijimësi.

Në programin e lëndës së filozofisë afërsisht **60-65%** (por jo më pak) e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **35-40%** e tyre janë për përpunimin e njohurive dhe për veprimtari të tjera që i shërbejnë realizimit të objektivave të programit dhe të vlerësimit të nxënësve përgjatë vitit shkollor dhe në fund të tij.

**Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese.** Zbatuesit e programit duhet të respektojnë numrin total të orëve të lëndës, por kanë të drejtë të pakësojnë ose të shtojnë deri në masën 10% të orëve për çdo linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur ve re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të

linjës/kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm të objektivave.

### **Përpunimi i njohurive**

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një linje (kapitulli) të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një linje (kapitulli) me njohuritë e linjave, kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- projektin kurrikular lëndor;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja dhe në blloqe tematike, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (i sugjeruar).

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj. (Jepni nga një shembull për konkretizimin e këtyre elementeve të programit)

Në orët mësimore, që i përkasin **përpunimit të njohurive**, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Në këtë pikë mund dhe duhet që mësuesi t'i kushtojë vëmendje refleksionit të mendimit filozofik, të koncepteve dhe rryma të mëdha filozofike në hapësirën shqiptare; jehonën e tyre në shkolla, në organet e shtypit, në kulturën e të menduarit dhe të jetesës.

**Mendimi shqiptar ose ndikimi i mendimit të përparuar botëror në mendimin filozofik në Shqipëri mund të jetë objekt i eksplorimit nga nxënësit në formën e projektit kurrikular, të eseve e të detyrave të tjera të pavaruara që mundësohen në kuadrin e përpunimit të njohurive.**

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive filozofike, dhe këtë mundësi filozofia e krijon, si nëpërmjet përmbajtjes ashtu edhe nëpërmjet metodave, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si: aftësia e komunikimit, aftësia e manaxhimit të informacionit, aftësia e zgjidhjeve problemore, aftësia e të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive që lidhen me veçoritë e lëndës;
- të qëndrimeve, si zhvillimi i interesit për filozofinë dhe të filozofuarit.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

## **5. VLERËSIMI**

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi. Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet e shkurtër për një objektiva të veçuar të të nxënësve, deri tek ato një orësh; teste me alternativë ose zhvillim, ese, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar. Një mundësi vlerësimi dhe vetëvlerësimi është **portofoli i nxënësve**, që është një përmbledhje e punimeve të tij/saj përgjatë një periudhe të caktuar kohe ose gjatë gjithë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

**Në vlerësimin përfundimtar, mësuesi duhet të mbajë parasysh peshën e ndryshme që zë në këtë vlerësim vlerësimi i aftësive të niveleve të ndryshme intelektuale.**

Në vlerësim, mësuesi duhet të marrë parasysh çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtazi nga emigracioni etj. Ai duhet t'u krijojë mundësi këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar ato me shkrim ose me gojë.

Kompetencat e lëndëve shoqërore, pra edhe të filozofisë, përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: **njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare.** Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për vlerësimin e arritjeve të nxënësve.

**Njohuritë** përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetje të tilla, si:

- Cilat janë kushtet që çuan në lindjen e filozofisë në Greqinë e Lashtë?
- Cilët janë pikëpamjet filozofike që karakterizojnë periudhën mesjetës?
- Cili është qëndrimi i Niçes ndaj fesë dhe cilët janë filozofët që ndajnë të njëjtin mendim me të?

**Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse** përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës. Aftësitë intelektuale i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë filozofike në jetën e tyre të përditshme. Këto aftësi i ndihmojnë ata të **identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuara për çështje të ndryshme filozofike, politike, morale etj.**

**Aftësitë pjesëmarrëse** i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë në jetën politike, morale etj., duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë mundësisht nga pikëpamja filozofike idetë dhe interesat e tyre etj.

**Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve,**

Elementi i tretë janë *prirjet qytetare* që përshkruajnë të gjitha aspektet e jetës së individit. Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një mendimtar i pavarur i shoqërisë;
- për të respektuar vlerat dhe pikëpamjet vetjake dhe të të tjerëve;
- për të marrë pjesë në diskutime dhe në vendimmarrje në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme.

**Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**